

VENDIM
Nr. 238, datë 21.3.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIMI I RRUGËS ‘XOXI ANDONI’ DHE HAPËSIRAVE RRETH SAJ”,
SHITESAT, FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës ‘Xoxi Andoni’ dhe hapësirave rreth saj”, shtesat, Fier.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Fier.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 26 492 996 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 26 492 996 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
 6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
 7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Fier.
 8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VLERËSIME PËRFUNDIMTARE PËR PASURITË PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË REALIZIMIT TË PROJEKTEVE PËR INTERES PUBLIK

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË SHITESË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “REHABILITIMI I RRUGËS ‘XOXI ANDON’ DHE HAPËSIRAVE RRETH SAJ”, FIER

Nr.	Emër mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e përgj. e truallit (m²)	Sip. e prekur e truallit (m²)	Çmimi për truallin (lekë/ m²)	Vlera e truallit (lekë)	Sip. totale e ndërtesës me certifikatë (m²)	Sip. e prekur e ndërtesës (m²)	Amortizimi (%)	Vlera e ndërtesës me preventiv (lekë)	Vlera e përgjith. (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Anastas Andon Gjata	8534	3/459	234.40	24.65	12,893	317,812	229.00	17.05	5%	663,110	980,922	Konfirmim nga ZVRPP-ja
2	Safet Qenan Troka	8534	3/468	50.00	50.00	12,893	644,650	-	-	-	-	644,650	Inskriptuar 2 herë në favor të Luan Toska dhe Bledar Toska
3	Agron Sulciman Xhafa + bashkëpronarë	8534	3/33	1,627.00	1627.00	12,893	20,976,911	-	-	-	-	20,976,911	Konfirmim nga ZVRPP-ja
4	Imer Ismail Osmënaj	8534	3/65 - N2	-	-	-	-	43.60	43.60	20%	699,138	699,138	Konfirmim nga ZVRPP-ja
5	Hena Halim Rizaj	8534	3/65 - N5	15.90	15.90	12,893	204,999	31.80	31.80	30%	446,182	651,181	Plotësim dokumentacion i në lidhje me truallin
6	Flamur Myrdar Kondi	8534	3/290	60.00	60.00	12,893	773,580	33.00	33.00	5%	1,766,614	2,540,194	Inskriptuar në favor të Fondit Besa sh.a.
Vlera totale											26,492,996		

Vlerësimi është bërë duke zbatuar VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik” dhe VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.